REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 42/17
Date/Datum. 27.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova –Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

REFERENCË:	42/17
PËR:	- Zyrtarit e prokurimit të AK-së- Komuna e Klinës - Parashtruesit të ankesës **"ALBKOS INT" NTSH** me seli në Fushë Kosovë
CC:	- Panelit Shqyrtues në OSHP, - Arkivës në OSHP
NGA:	Sabrije Bullatovci, Ekspert shqyrtues i prokurimit
TEMA:	Raporti i vlerësimit të ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar **"ALBKOS INT" NTSH** me seli në Fushë Kosovë, me numër protokollit 42/17, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Servisimi-mirëmbajtja e aparaturave kundër zjarrit"**, me nr. të prokurimit 634/16/073/221, kundër vendimit të Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna e Klinës.

Lokacioni:	Prishtinë	Data:	24.02.2017
PËR AKTIVITET			X
SIÇ ËSHTË KËRKUAR			X
PËR KOMENTE			X
PËR INFORMIMIN TUAJ			X

Bazuar në nenin 113 dhe 114 të LPP të Kosovës, ju njoftojmë me raportin e ekspertizën lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Servisimi-mirëmbajtja e aparaturave kundër zjarrit"**, me nr. të prokurimit 634/16/073/221, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Klinës, si dhe me përgjigjen ndaj pretendimeve ankimore të OE ankues **"ALBKOS INT" NTSH** me seli në Fushë Kosovë, me numër protokollit 42/17.

Konform nenit *113 dhe 114*, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues i pavarur , ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si dhe kërkesën e AK-së, dhe ka konstatuar si më poshtë:

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë,të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		15.02.2017		16.02.2017		24.02.2017
Nënshkrimi i ekspertit		*data e autorizimit të eksp.*		*data e fillimit të ekspertizës*		*data e dorëzimit të raportit*

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit-

Me datë 10 shkurt 2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën e parashtruar nga OE **"ALBKOS INT" NTSH** me seli në Fushë Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Servisimi-mirëmbajtja e aparaturave kundër zjarrit"**, me nr. të prokurimit 634/16/073/221, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Klinës.
Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa VIII e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i OSHP-së e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë:

N. 109,-Operatoret Ekonomik Ankues: "ALBKOS INT" NTSH me seli në Fushë Kosovë

Pikat e Ankesës:

- Shkelje e nenit 1, Qëllimi;
- Shkelje e nenit 6 të LPP-së, Ekonomiciteti dhe Efekistatitit;
- Shkelje e nenit 7 të LPP-së, Barazia në Trajtim / Jo Diskriminim;
- Shkelej e nenit 10 të LPP-së,Mjetet për promovim të transparencës;
- Shkelje e nenit 59 të LPP-së, Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
- Shkelje e nenit 61 të LPP-së, Kriteret për Dhënie të Kontratës;
- Shkelje e UA 03/2015
- Shkelje e UA 02/2015
- Shkelje e paragrafit 30.1 të dosjes së tenderit, ku në kriteret për dhënie të kontratës është precizuar tenderi i përgjegjshëm Çmimi me i ulët sipas kritereve : Servisim i rregullt pesha 40%, Mbushja e aparateve 30%, Pjesët dhe furnizimi 30%.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

- Pas njoftimit për eliminim nga aktiviteti i prokurimit me 29.12.2016, me ç'rast njoftohemi se OE "Pastor Kosova" është propozuar për tu shpërblyer me kontratë me çmim të përgjithshëm prej 55,584.00€, kurse ne rangun ne pozicionin e fundit (pozicionin e tretë) me çmim prej 70,884.00, me datën 30.12.2016, kemi parashtruar kërkesë për rivlerësim.

- Kërkesa jonë për rivlerësim pranohet nga ana e AK-së, tenderi kthehet ne rivlerësim kurse me dt 30.01.2017, njoftohemi serish që kemi qenë të pasuksesshëm për shkak se jeni ranguar në pozicionin e tretë (si më të shtrenjtit), por tani me çmim prej 11.852,00 EUR (çmimi i mëparshëm 597% më i lartë se çmimi i tanishëm), ndërsa sërish është

propozuar për tu shpërblyer me kontratë OE "Pastor Kosova" me çmim prej 9.382,30 EUR (ku vërehet se çmimi i mëhershëm i kalkuluar ka qenë 592% më i lartë se çmimi i tanishëm)

- Duke marr parasysh që çmimi prej 9.382,30 EUR i OE të propozuar për tu shpërblyer me kontratë nuk përputhej ne asnjë skenë kalkulimi, por edhe për shkak të gabimeve paraprake me diferencë mbi 500%, me datën 30.01.2017 kemi kërkuar qasje në procesverbalin e vlerësimit ose informata për mënyrën e vlerësimit. Me këtë rast na është refuzuar qasja në procesverbalin në fjalë, duke shkelur Nenin 10 të LPP, kurse si njoftim kanë dhënë që "Nga konsultimet me KRPP rivlerësimi është bërë konform LPP-së, Udhëzuesit për Prokurim Publik pika 28.11; 28.12; 28.13; 28.14 dhe 28.15".

- Pasi që sërish kishte shkelje flagrante të LPP-së, por edhe të kritereve të parapara me dosje së tenderit, më datën 01.02.2017, kemi bërë sërish kërkesë për rishqyrtim (ku në mënyrë të detajuar kemi bërë përshkrimin mbi shkeljet e supozuara), kurse të nesërmen na është dërguar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, me arsyetim se AK-ja ka vepruar konform LPP-së.

- Meqenëse ne kërkesën për shqyrtim të datës 03.02.2017, e cila është pjesë e këtij dokumenti, i kemi dhënë në mënyrë të detajuar shkeljet, në rreshtat në vijim do të mundohemi qe edhe njëherë sa më shkurt ti japin vetëm disa nga këto shkelje:

a). Ne dosjen e tenderit, janë dhënë sasitë indikativë si më poshtë:

Pjesa	Përshkrimi	Fushëveprimi	Sasia Indikiative		
1	Servisimi i rregullt i aparateve ne dispozicion				
2	Mbushja e aparateve ne dispozicion				
3	Pjesët – Furnizimi me pjesë dhe aparate tjera S6				

Këto janë sasitë indikativë - momentale te planifikuara e cila do te llogaritet për çmimin ne njësi sasitë mund te rritet apo zvogëlohet varësisht nga nevojat. Bazuar ne nenin 22 LPP 05/L-068 vlera monetare mund te jete (+) (-) 30 % e vlerës se planifikuar te kontrates. Çmimet për njësi do te vlejnë.

b). Ne Sqarimet e datës XX.XX.XXXX (dok.nr.xx) në mënyrë eksplicite ceket "Sasia do te jete 30 cope vetëm S5" dmth ne poz. 3.1 (tabela 3) do të blehen vetëm Aparate për fikjen e zjarrit - S6.

c). Kriteret për dhënie të kontratës kanë qenë:

Çmimi më i ultë me poentim sipas kritereve:

Kategoria 1 Përshkrimi Pesha

1. Servisim i rregullt 40%
2. Mbushja e aparateve 30 %
3. Pjesët dhe furnizimi 30%

Vlera e parashikuar 50.000, 00 EUR

Megjithatë me rastin e vlerësimit asnjë nga kriteret e mësipërme nuk janë respektuar, pasi që me rastin e kalkulimit të çmimit final është vepruar si më poshtë:

Çmimi final i TABELËS 1, SERVISIMI I RREGULLIT është shumëzuar me gjashtë (6) duke supozuar që do të bëhen nga dy servisime ne vit, gjë që sipas LIGJIT NR. 02/L-41 PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI, përkatësisht paragrafit 20.2 **"aparatet bartëse dhe lëvizëse për shuarjen e zjarreve fillestare duhen të kontrollohen 2 herë ne vit (çdo 6 muaj)". Shih linkun:** https://gzk.rks.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2499.

Në bazë të këtij kalkulimi fitojmë këto rezultate finale për 36 muaj (për nga dy servisime në vit):

TABELA 1 (SERVISIMI I RREGULLT- 2 X NË VIT SIPAS LIGJIT PËR MKZ LIGJIT NR. 02/L-41 PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI)

Nr. Përshkrimi	Njësia	Sasia e Vlerësuar	PASTOR KOSOVA				ALBKOS INT & BESARTI			
			Çm.njësi DDP1 €	Çmimi total- €	Totali për 36 muaj	Pesh. Çmimit 40%	Çm.njësi DDP1 €	Çmimi total- €	Totali për 36 muaj	Pesh. Çmimit 40%
SERVISIMI I RREGULLT			A	B	C	D	A	B	C	D
1.1 Aparate për fikjen e zjarrit S6	cope	121	7,50	907,50	5.445,00	2.178,00	5,00	605,00	3.630,00	1.452,00
1.2 Aparate për fikjen e zjarrit S9	cope	24	7,00	168,00	1.008,00	403,20	5,00	120,00	720,00	288,00
1.3 Aparate për fikjen e zjarrit P6	cope	13	7,00	91,00	546,00	218,40	4,50	58,50	351,00	140,40
1.4 Aparate për fikjen e zjarrit P9	cope	8	7,00	56,00	336,00	134,40	3,50	28,00	168,00	67,20
1.5 Aparate për fikjen Gaslink Philips	cope	3	4,00	12,00	72,00	28,80	2,00	6,00	36,00	14,40
1.6 APARATA CO2	cope	1	4,00	4,00	24,00	9,60	2,00	2,00	12,00	4,80
TOTALI				**1.238,50**	**7.431,00**	**2.972,40**		**819,50**	**4.917,00**	**1.966,80**

Sqarim:

Në kolonën A-janë dhënë çmimet për njësi për një servisim (brenda gjashtë muajsh),

Në kolonën B – është dhënë çmimi total për tërë sasinë për një servisim,

Në kolonën C - është dhënë çmimi total për 36 muaj (për gjashtë servisime, nga dy servisime në brenda vitit Sipas) Ligjit për mbrojtje nga zjarri,

Në kolonë D - është bërë peshimi i çmimit në përputhje me Paragrafin 30.1 të dosjes së tenderit, ku në kriteret për dhënie të kontratës, ku është precizuar Tenderi i përgjegjshëm Çmimi me i ulet si dhe UA 03/2015.

Siç mund të shihni çmimi i kons. "Albkos & Besarti" është për 2.514,00 EUR, më i ultë se sa i OE të propozuar për të shpërblyer me kontratë.

Po në këtë mënyrë, AK ka bërë edhe kalkulimin e çmimeve edhe ne dy tabelat të tjera, pra duke shumëzuar Çmimin total me gjashte (6), sikur të bëhen nga dy blerje brenda vitit (d.m.th. 6 blerje për 36 muaj), edhe përkundër fakteve në vijim:

a) As në dosjen e tenderit e as në sasitë indikative nuk është specifikuar që do të ndodhin nga dy blerje brenda vitit

b) Mbushja e aparateve çdo gjashtë muaj nuk është obligative, por ajo bëhet vetëm sipas nevojës,

përkatësisht vetëm atëherë kur aparati është përdorur dhe zbrazur pas ndonjë intervenimi ose një herë në 5 vjet kur skadon garancia e pluhurit, kurse gjatë një Servisimi të rregullt bazuar në përvojën tonë, mbushja e aparateve për nuk ndodhë të jetë më e madhe se 5% e sasisë së gjithëmbarshme.

c) Pjesët rezervë (tabela 3) ndërrohen vetëm atëherë kur ato prishen, kurse sasia e pjesëve të prishura është minimale dhe prishen vetëm në pjesë të caktuara, por edhe nëse ndodhë gjasat që të prishet secili aparat dhe atë çdo gjashtë muaj janë të pamundura.

d) Në sqarimet me shkrim, për pozicionin 3.1 në mënyrë eksplicitet ceket "Sasia do te jete 30 cope vetëm S6", prandaj si mund të llogaritet kjo sasi duke u shumëzuar me 6, sikur të blihen 180 cope.

P.sh. sipas kësaj mënyre të kalkulimit, AK do të blejë :

" 300 copë bombola (poz. 3.2) për 121 aparate S6 (Poz. 1.1), ose 179 cope më shumë se sa numri i aparateve që kanë në dispozicion, ose edhe sikur të shfrytëzohet e drejta për të porositur 30% më pak, sërish numri i pjesëve rezervë është dukshëm më i lartë se sa i aparateve në dispozicion!!!

- 60 fiskaia (poz. 3.4) dhe mekanizma komplet (poz. 3.7) për aparatin S3 edhe pse nuk e kanë asnjë aparat të tillë në dispozicion.

-Njësoj është situata edhe me aparatin CO2-5 (poz. 2.6), për te cilin kanë kërkuar 30 copë mekanizma komplet, kurse ne dispozicion kanë vetëm një aparat të tille (29 mekanizma me tepër se nevojat eventuale). –

TABELA 2 (MBUSHJA VE VATERJALIN E NEVOJSHËM)

Nr. Përshkrimi	Njësia	Sasia e Vlerësuar	PASTOR KOSOVA				ALBKOS INT & BESARTI			
			Çm.njësi DDP1 €	Çmimi total- €	Totali për 36 muaj	Pesh. Çmimit 30%	Çm.njësi DDP1 €	Çmimi total- €	Totali për 36 muaj	Pesh. Çmimit 30%
Mbushja me materialin e nevojshëm			A	B	C	D	A	B	C	D
2.1 Aparate për fikjen e zjarrit S6	cope	121	0,10	12,10	12,10	3,63	2,30	278,30	278,30	83,49
2.2 Aparate për fikjen e zjarrit S9	cope	24	0,10	2,40	2,40	0,72	4,00	96,00	96,00	28,80
2.3 Aparate për fikjen e zjarrit P6	cope	13	0,10	1,30	1,30	0,39	2,30	29,90	29,90	8,97
2.4 Aparate për fikjen e zjarrit P9	cope	8	0,10	0,80	0,80	0,24	4,00	32,00	32,00	9,60
2.5 Aparate për fikjen Gaslink	cope	3	0,10	0,30	0,300	0,09	2,00	6,00	6,00	1,80
2.6 APARATA CO2-5 kg	cope	1	0,10	0,10	0,10	0,03	2,00	2,00	2,00	0,60
TOTALI				**17,00**	**17,00**	**5,10**		**444,20**	**444,20**	**133,26**

Çmimi total prej17,00 EUR ose më pak se 1 cent për një kilogram i OE te propozuar për tu shpërblyer për kontratë, përveç faktit që është çmim jo normalisht i ultë, është edhe një edhe një argument i forte qe tregon Se sasitë e dhëna me sipër janë te pasakta. Duke marr parasysh qe kane ndikim të drejtpërdrejt në përcaktimin e Çmimit final, nga AK kemi kërkuar qe te veproje konform nenit 61 te LPP, por një gjë te tille e refuzuar.

NË TABELËN 3 (FURNIZIME ME PJESE DHE APARATE TE REJA)

Nr. Përshkrimi	Njësia	Sasia e Vlerësuar	PASTOR KOSOVA				ALBKOS INT & BESARTI			
			Çm.njësi DDP1 €	Çmimi total- €	Totali për 36 muaj	Pesh. Çmimit 30%	Çm.njësi DDP1 €	Çmimi total- €	Totali për 36 muaj	Pesh. Çmimit 30%
Furnizim me pjese dhe aparate te reja			A	B	C	D	A	B	C	D
3.1 Aparate për fikjen e zjarrit S6	cope	30	9,00	270,00	270,00	81,00	18,00	540,00	540,00	162,00
3.2 Furnizim me bombola per aparata S6	cope	50	0,10	5,00	5,00	1,50	0,10	5,00	5,00	1,50
3.3 Furnizim me bombola per aparata S9	cope	20	0,10	2,00	2,00	0,60	0,10	2,00	2,00	0,60
3.4 Furnizim me fiskaja per aparata S3	cope	10	0,10	1,00	1,00	0,30	0,10	1,00	1,00	0,30
3.5 Furnizim me fiskaja per aparata S6	cope	50	0,10	5,00	5,00	1,50	2,00	100,00	100,00	30,00
3.6 Furnizim me fiskaja per aparata S9	cope	10	0,10	1,00	1,00	0,30	2,00	20,00	20,00	6,00
3.7 Magnezium komplet per aparata S3	cope	10	0,10	1,00	1,00	0,30	1,00	10,00	10,00	3,00
3.8 Magnezium komplet per aparata S6	cope	20	0,10	2,00	2,00	0,60	1,00	20,00	20,00	6,00
3.9 Magnezium komplet per aparata S9	cope	10	0,10	1,00	1,00	0,30	1,00	10,00	10,00	3,00
3.10 Magnezium komplet per aparata CO2	cope	5	0,10	0,50	0,50	0,15	1,00	5,00	5,00	1.50
TOTALI				**288,50**	**288,50**	**86,55**		**713,00**	**713,00**	**213,90**

Siç mund te shihet nga tabela e mësipërme, OE "Pastor Kosova" në mënyrë lineare ka dhanë çmim 0,10 EUR, përveç poz.1, çmime të cilat janë jo normalisht të ulëta, gjë që lënë për të kuptuar që këto sasi janë dhënë vetëm në mënyrë fiktive.

Po ashtu ne Sqarimet e datës XXXX.XXXX AK në mënyrë eksplicite ka cekur se "Sasia do te jete 30 cope vetëm S6" (shih poz. 3.1) do të blihen vetëm Aparate për fikjen e zjarrit - S6., prandaj kalkulimi i çmimit final duke e shumëzuar me 6 është gabim dhe ne kundërshtim me nenin 59 të LPP.

Bazuar në faktet e sipër përmendura, pra nëse çmimet kalkulohen në respekt të plotë të LPP dhe kritereve të përcaktuara me dosje të tenderit dhe si do që të bëhet krahasimi i çmimit, me ose pa peshim, del që ne kemi çmim me te ulet se sa OE i propozuar për t'u shpërblyer me kontratë: "Pastor Kosova" (7.431,00 + 17,00 + 288,55) = 7.736,55 EUR kurse çmimi qe kemi ofruar ne Kons. "Albkos & Besarti" (4.917,00 + 444,2O + 713,00) = 6.074,20 EUR.

Prandaj, nga OSHP kërkojmë që lënda të kthehet në rivlerësim, në mënyrë që tenderi të rivlerësohet dhe të vendoset në përputhje me LPP-së.

Procesi i prokurimit

Data e autorizimit të prokurimit nga zyrtari autorizues(N.22.1).....03.11. 2016

Data e njoftimit për kontratë (N. 40) 17.11.2016

Lloji i procedurës së aplikuar (N.33-38):-.....Procedura e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar(N.16): .....Shërbime /e mesme

Vlera e përllogaritur për këtë prokurim (N.15-19): ..... 50,000.00 € 36muaj

Data dhe vlera e akordimit të mjeteve financiare nga AK (N.9): .....

Afati kohor për pranimin e projekteve (gjithsejtë ditë): 12.12.2016

Kriteret për vlerësim

Kriteri për dhënien e kontratës (N.60): ..... Tenderi i përgjegjshëm ,Çmimi më i ulët. Me poentim . UA 03/2015

kategoria	Përshkrimi	Pesha	
1	Servisim i rregullt	40 %	
2	Mbushja	30 %	
3	Pjesët – furnizimi	30 %	

Kërkesat (administrative) për përshtatshmëri (N.65-69):

- DEKLARATA NEN BETIM
- VERTETIMI NGA GJYKATA
- VERTETIMI NGA ATK

Dëshmitë dokumentare:

1. Deklarata nën betim e nënshkruar dhe vulosur nga tenderuesi(duhet dorëzuar së bashku me tenderin).

Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet .

Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise janë me se vijon:

a. Për situatën referuar nenit 65, paragrafi 3, nen-paragrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4, nen-paragrafi 4.1, 4.2, dhe 4.4, vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit.

b. Vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.

Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 6 si dhe në rastin kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme.

Kërkesat përshtatshmërisë profesional (N. 66):

a. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
b. Regjistrimi në TVSH; dhe
c. Regjistrimi i Numrit Fiskal.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a) Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit);
b) Një kopje e certifikatës se TVSH; dhe
c) Një kopje e certifikatës se numrit fiskal.

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare (neni 68 të LPP-së)

- Sigurimi i ekzekutimit 10%, vlerës së kontratës

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

/

Kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale (neni 69 të LPP-së)

a) Lista e kontratave te përfunduara nga vitet 2013-2014-2015 kryesore të rëndësishme të shërbimeve të ngjashme të realizuara
b) Referenca- Minimum tri referenca kryesore të rëndësishme të shërbimeve të ngjashme të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare (2013,2014,2015); dhe
c) Servis i certifikuar për servisim dhe mirëmbajtje te aparaturës përkatëse
d) Stafi – regjistri i stafit –Min 2 te punësuar

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a) Lista e kontratave te përfunduara për shërbime te ngjashme ne tri vitet e fundit 2013-2014-2015 , Institucioni , vlerat dhe kohen .
b) Kopjet e referencave apo pranime teknike min. Tri për kryerje të shërbimeve të ngjashme në tri vitet e shkuara (2013,2014,2015)
c) Certifikatën e Licencës se servsisit
d) Regjistri i stafit te kualifikuar për ketë shërbim -Kualifikimet e stafit .Min 2 te punësuar

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N. 58):

Nr.	Emri i OE	Vendi	Çmimi
1.	"PASTOR KOSOVA"	Prishtinë	1544.00€
2.	"ALBAKOS& BESARTI"	Pejë	1976.70€
3.	NPSH "EMERGJENCA"	Prishtinë	1963.00€

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve konstatohet se ne hapjen e ofertave kanë marrë pjesë përfaqësuesit e 3 (tre) OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik dhe çmimi.

Komisionet vlerësues pran AK

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N. 59).

Autoriteti kontraktues, me dt. 10 janar 2017, ka caktuar komisionin për vlerësimin e tenderëve në përbërje prej 3 (tre) anëtarëve, si në vijim:

- Xhevdet Berisha, Inxh. i dip. i Makinerisë- Kryetar i komisionit
- Isa Gashi, Ekonomist, Anëtar
- Elmi Krasniqi, Jurist-Anëtar

Data e fillimit dhe mbarimit të vlerësimi:..... 26.01.2017

Data e njoftimit për dhënie të kontratës (N. 41):.....30.01.2017

Data e vendimit të AK-së mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE (N. 108/A):.....02.02.2017

Raporti i komisionit vlerësues

Bazuar në raportin e vlerësimit të tenderëve, komisioni vlerësues konstatoj se 3 (tre) operator ekonomik që kanë ofertuar, ne aktivitetin e prokurimit **"Servisimi-mirëmbajtja e aparaturave kundër zjarrit"**, me nr. të prokurimit 634/16/073/221, ku të gjithë operatoret ekonomik i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Duke u bazuar ne ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, propozohet për dhënie të kontratës operatori ekonomik i renditur për çmimin më të ulet "PASTOR KOSOVA" me seli ne Prishtinë.

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues (N. 113,114)

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të Lëndës Tenderime, është konstatuar, si në vijim:

Sqarimi: Nr. 1 (mbarëvajtja e procedurës së prokurimit).

Ekspertja shqyrtues bazuar ne dokumentacioni që ka në shqyrtim konstaton se autoriteti kontraktues në aktivitet të prokurimit **"Servisimi-mirëmbajtja e aparaturave kundër zjarrit"**, me nr. të prokurimit 634/16/073/221, ka aplikuar procedurën hapur. Lloji i kontratës është kontratë publike kornizë 36 muaj, shërbime, vlerë e mesme. Dosja e tenderit përfshinë termet dhe kushtet materiale të saja, procedurën e zbatueshme të prokurimit, kërkesat të aplikueshme të përshtatshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes.

Sqarimi: Nr. 2

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 6 të LPP-së, ekspertja shqyrtues vlerëson se autoriteti kontraktues është i obliguar që fondet publike dhe burimet publike të përdorë në mënyrë ekonomike, duke pasur parasysh qëllimin dhe lëndën e kontratës, prandaj autoriteti kontraktues konform nenit 6 të LPP-së, ka përgjegjësi për mos shfrytëzim të drejt fondeve publike dhe burimeve publike.

Sqarimi: Nr. 3

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti ka bërë shkelje të nenit 10 të LPP-së, ekspertja shqyrtues bazuar ne shkresat e lëndës sqaron se operatori ekonomik ankues përmes shkresës elektronike (e-malit) të dt. 31 janar 2017, adresuar autoritetit kontraktues ka theksuar: nuk pajtohemi me këtë vendim tuja sepse nuk keni marrë për bazë kërkesën tonë për rishqyrtim përkatësisht nuk keni marrë për bazë fare shkeljet e ligjit nenin 61 të LPP-së për operatorin e propozuar për tu shpërblyer me kontratë. Prandaj, ju lutem na dërgoni raportin e vlerësimit ose na krijoni mundësin për qasje ne dokumentacionin e tenderit.

Po të njëjtën datë autoriteti kontraktues i kthen përgjigjeje operatorit ekonomik ankues ku thuhet: Kërkesa e juaj është marr dhe nga ai aspekt është bërë edhe ri vlerësimi. Nga konsultimi me KRPP, rivlerësimi është bërë konform LPP-së, Udhëzuesit për Prokurim Publik pika 28.11, 28.12,28.13,28.14 dhe 18.15. Për kundër, kësaj me qenë se është proces i rivlerësimit mund të bëni kërkesë për rishqyrtim konform nenit 108/A të LPP-së.

Bazuar ne atë që u tha më lartë, ekspertja shqyrtues sqaron se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, për faktin se autoriteti kontraktues nuk i ka lejuar qasje ne dokumentacion të tenderit operatorit ekonomik ankues ashtu si parashihet ne nenin 10 paragrafi 3 të LPP-së, ku thuhet: *autoritetit kontraktues është i obliguar që pas kërkesës me shkrim nga cilado palë e interesit, ti i siguron qasje të arsyeshme palës- operatorit ekonomik ankues që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur.* Ndërsa, në paragrafin 5 të nenit 10 thuhet: "*Autoriteti kontraktues, me kërkesë të një pale të interesuar, do të bëjë dhe do t'i sigurojë palës së tillë të interesuar një kopje të çfarëdo materiali në të cilin pala e tillë e interesuar ka të drejtë qasjeje sipas paragrafit 3 të këtij neni*".

Sqarimi: Nr. 4

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku ndër të tjera thuhet: "*Kalkulimi i çmimit final duke e shumëzuar me 6 është gabim dhe ne kundërshtim me nenin 59 të LPP-së*", ekspertja shqyrtuese bazuar ne raportin e vlerësimit respektivisht të vlerësimit të tri kategorive të peshuar te kriterin për dhënie të kontratës çmim më i ulët i peshuar, sqaron se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, për arsye komisioni i vlerësimit ka llogaritur çmimin total me here (x) 6, ndërsa në dosjen e tenderit te përshkrimi i çmimit është cekur sasi vlerësuar, çmimi njësi, çmimi total, që rezulton se nuk është cekur që çmimi total do të shumëzohet me 6, respektivisht se do të bëhen nga 2 servisime brenda vitit gjatë kohë zgjatjes së kontratës ne fjalë.

Bazuar ne atë që u tha më lartë ekspertja shqyrtues sqaron se komisioni i vlerësimit në rastin konkret ka vepruar në kundërshtim me neni 7 paragrafi 6 pika (v) ku thuhet: "asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar në njoftimin për kontratë dhe dosjes të tenderit, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies".

Sqarimi: Nr. 5

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 61 të LPP-së, se nëse krahasohen çmimet e ofruara nga operatorit ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës (te tabela 2 pozicionet 2.1 deri në 2.6 që janë ofruar me 0.10€ dhe te tabela 3. pozicionet 3.2 deri 3.10, e që janë ofruar me 0.10€), me operatorin ekonomik ankues që ka ofruar çmim për të njëjtat pozicione siç janë 4.00€, 2.00€, 1.00€ apo të OE NPSH "EMERGJENCA" që ka ofruar çmim për të njëjtat pozicione siç janë 4.00€, 3.00€, rezulton se është çmim i ulët, mirëpo eksperti shqyrtues bazuar në nenin 61 i LPP-së, vlerëson se është drejtë dhe përgjegjësi e autoritetit kontraktues që të konsideron një tender të dorëzuar me çmim jo normalisht të ulët apo jo, që do të thotë se në rastin konkret autoriteti kontraktues respektivisht komisioni i vlerësimit të ofertave, tenderin e dorëzuar nga operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk e ka vlerësuar si çmim jo normalisht të ulët.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues

Gjatë analizimit të dosjes së tenderit dhe procedurës së zhvilluar për aktivitetin e **"Servisimi-mirëmbajtja e aparaturave kundër zjarrit"**, me nr. të prokurimit 634/16/073/221, i rekomandon panelit shqyrtues që ankesa e operatorit ekonomik ankues të aprovohet si e bazuar, ndërsa autoriteti kontraktues të anuloj vendimin njoftim për dhënie të kontratës, të dt. 31 janar 2017, dhe lëndën ta kthej ne Rivlerësim.